



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, merr këtë

V E N D I M
P Ë R

**FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS
SË KUVENDIT PËR VITIN 2019**

- I. Miratohet Vendimi për formimin e grupi punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019.
- II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:
1. Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit,
 2. Jeta Rafuna-Hasani, LDK, anëtare,
 3. Egzon Azemi, LVV, anëtar,
 4. Bashkim Beha, PSD, anëtar,
 5. Leutrim Retkoceri, PDK, anëtar,
 6. Valbona Ajeti, AAK, anëtare,
 7. Arbenita Murseli, AKR, anëtare,
 8. Bukurie Canolli, LB, anëtare,
 9. Baton Dushi, Nisma, anëtar,
 10. Florina Rrahmani, përfaqësuese e Zyrës ligjore, anëtare,
 11. Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,
 12. Luljeta Selimi, përfaqësuese e Sektorit për punë të Kuvendit, anëtare.
- III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të Komunës për miratim.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/04-0291301/18, më 11.12.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://eet.prishtina-komuna.org>

